

Datë 13.11.2023.

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës – Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Shërbime për riparimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve elektroshtëpiake”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
*Shërbime për riparimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve hotelierike 50883000-8***

VLERA E FONDIT LIMIT:

Vlera e pritshme e kontratave (Fondi limit):

Fondi limit: 1 805 900 *(një milion e tetëqind e pesë mijë e nëntëqind) Lekë pa Tvsh*

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Perlllogaritja e fondit limit është kryer mbeshtetur ne nenet 12 dhe 13 te VKM nr 285 date 19.05.2021, ne Udhezimin nr 30 date 27.12.2021 ” Mbi menaxhimin e aktiveve ne njesite e prokurimit publik”, te ndryshuar Kapitulli II , pika 23, mbi bazen e studimit te tregut nga struktura e ngritur nga AK per kete qellim, duke iu drejtuar 3 operatoreve ekonomike ne treg qe operojne ne fushen e ketij objekti prokurimi, pasi nuk egzistojne cmime reference zyrtare per keto lloj sherbimesh .

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

1.1 *Ofertuesi duhet të paraqesë:*

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Operatori ekonomik duhet të ketë objekt të veprimtarisë mirëmbajtjen e pajisjeve hotelierike. Kjo e vertetuar me ekstraktin e QKB.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Xhiroja vjetore minimale e të paktën njërit prej 3 (tre) vjetëve të fundit financiare të jetë jo më e vogël se 20% e vlerës së fondit limit të kontratës. (Referuar Nenit 43 pika 2/c dhe pika 3 dhe neni 55 pika 4 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 (te ndryshuar).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës. Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike".

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2020, 2021, 2022) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, ndërsa kushti që *bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar është vendosur në zbatim të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar.*

- i. OE te paraqes nje dokument që vërteton se i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2023, referuar Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, në të gjitha njësitë e qeverisjes vendore ku operatori ekonomik ka selinë dhe ku ka zhvilluar apo zhvillon veprimtarinë e tij. (Sipas ekstraktit të thjeshtë dhe historik të operatori ekonomik

lëshuar nga QKB).

- ii. (Ne rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anetar i bashkimit).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, në nenin 43, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatoreve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2023 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik

ofertues të paraqese deshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë tre viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontrates** në vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate (vlerës së kontratave të pritshme).
(Referuar neni 55 pika 4/b të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 të ndryshuar)

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën, vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, kontratën e shërbimit, si dhe faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara

(Nisur nga fakti që mirëmbajtje të kësaj natyre realizohen për herë të parë do të konsiderohen kontrata të ngjashme edhe mirëmbajtja e pajisje të tjera elektroshtëpiake si soba për ngohje apo gatim, kondicionerë dhe pajisje të kësaj natyre).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe neni 55, pika 4/b në kushtet kur kjo procedurë prokurimi është procedurë e thjeshtuar të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të

përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 20 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë minimalisht të punësuar e siguruar sipas legjislacionit të kodit të punës në fuqi 3 (tre) punonjës, prej të cilëve:

1 (nje) Inxhinier elektrik/elektronik/mekanik, për të cilin operatori duhet të paraqesë:

- a) Diplomën
- b) Kontratën Individuale të punës

Të ketë në stafin e punonjesve të pasqyruar në listëpagesat e shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi **per dy muajt e fundit** punonjësit e mëposhtem:

1 (një) punonjës hidraulik i pajisur me dëshmitë përkatëse të kualifikimit të sigurimit teknik.

1 (një) punonjës elektrikist i pajisur me dëshmitë përkatëse të kualifikimit të sigurimit teknik.

për të cilin operatori duhet të paraqesë:

- a) Dëshmine perkatese
- b) Kontratën Individuale të punës

Argumentimi; Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6 gjerat c) dhe ç), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht: Referuar natyrës së punimeve që kërkohen të prokurohen siç janë punimet për mirëmbajtjen e objekteve rezidenciale arsimore është e nevojshme pasja e një stafi teknik të kualifikuar e vërtetuar kjo në bazë të kodeve të punësimit të profesioneve të përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.514, datë 20.09.2017 “*Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP), të rishikuar*”, për realizimin me sukses të kontratës. Punonjësit e kualifikuar janë kërkuar duke u bazuar në numrin e objekteve në të cilat do të kryhen punimet si dhe natyrën dhe sasinë e punimeve që kërkohen. Me qëllim garantimit të realizimit të kontratës, stafi teknik inxhinierik dhe punonjësit e kërkuar nga autoriteti kontraktor duhet të figurojnë në listëpagesat e operatorit ekonomik ofertues.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka në pronësi ose me qira mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

- **Automjete ATP** **1 (një) Copë**
- **Peshore për peshimin e gazit** **1 (një) Copë**

- Aparat gazi (për mbushjen e frigoriferëve) 1 (një) Copë
- Komplet vegla pune elektrike/mekanike dhe për matje tokëzimi 1 (një) Copë

Në rast se mjete është në pronësi OE duhet të paraqesë:

- Faturë blerje,
- Certifikatë pronësie,
- Leje qarkullimi, siguracion, akt kolaudim, taksa vjetore.

Në rast se mjetet janë me qera, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Kontratë qiraje noteriale,
- Certifikatë pronësie te qiradhënësi,
- Leje qarkullimi, siguracion, akt kolaudimi, taksa vjetore.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 germa d), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se objekt i kësaj kontrate janë punimet për mirëmbajtjen e objekteve rezidenciale arsimore, të cilat duhet të realizohen sipas specifikimeve teknike, duhet të dëshmojnë që kanë minimalisht, makineritë dhe pajisjet mbrojtëse të përcaktuara më sipër. Ky kriter është vendosur, gjithashtu edhe për arsye se është çmuar si e nevojshme zotërimi i këtyre pajisjeve specifike, të konsideruar nga Autoriteti kontraktor si të domosdoshme për realizimin e punimeve në përputhje me ligjislacionin e punës. Referuar natyrës së objektit të prokurimit

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me certifikatat e mëposhtme (të vlefshme) objekti i të cilave të jetë në përputhje me objektin e prokurimit:

- Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë pajisur me Çertifikaten **ISO 9001:2015** ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme. (dokumentacioni të paraqitet në gjuhën shqipe ose i perkthyer dhe e noterizuar).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, është kërkuar kjo çertifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë çertifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë. Nisur nga rëndësia, volumi i kontratës, rëndësia e AK (Autoritetit kontraktor) të përfshirë në këtë procedurë është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedurë që operatori pjesëmarrës të provojnë se ka një sistem të menaxhimit të cilësisë, pra të demonstrojnë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht produkte që plotësojnë kërkesat e konsumatorëve pra të AK-së dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative me qëllim të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe sigurimin e konformitetit ndaj klientit pra Ak-së.

VËMENDJE: Me qëllim shmangjen e problematikave apo keqkuptimeve të mundshme, i bëjme me dije të gjithë operatorëve ekonomikë të interesuar, që gjatë hartimit të ofertës së tyre veçanërisht në seksionin e Kapacitetit teknik, ti referohen nenit 26 pika 6 të VKM 285 datë 19.05.2021, lidhur me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuar për kërkesat që përshihen në formularin e vetëdeklarimit. Koha për disponimin e dokumentacionit dëshmuar do t'u bëhet me dije operatorëve ekonomikë nga AK nëpërmjet SPE në momentin e përfundimit të vlerësimit nga KVO, por gjithësesi brenda 5 (pesë) ditëve nga vlerësimi i ofertave me qëllim që AK të vijojë me shpalljen e njoftimit të fituesit (neni 97/1 i LPP 162/2020).

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.